



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

№. 3221/ Prot

07. 20.06.22

Shkodër, më 15.06.2022

Nr. 370/1 Prot.

Lënda: Mbi Vendimin nr. 36, datë 26.05.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, pas administrimit të shkresës së ZABU Drin-Bunë nr. 226/1 prot., datë 09.06.2022 “Kthim përgjigje kërkesës për trajtim”, përgjigje e shkresës së Prefektit të Qarkut Shkodër nr. 369/1 prot., datë 02.06.2022 “Kërkesë për trajtim”, me anë të së cilës i është kërkuar nëse sipërfaqja e parashikuar për dhënie me qira sipas *VKB Vau Dejës nr. 36, datë 26.05.2022 “Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 1.8622 ha, nga e cila 1.7 ha për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme dhe 0.1622 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.”*, ngastra nr. 14a, ekonomia pyjore Gomsiqe, përfshihen në brigjet e liqenit të Vau Dejës dhe konfirmohet se janë nën administrimin e Zyrës së Administrimit të Baseni Drin-Bunë.

Referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, është në tagrin e Këshillit Bashkiak dhënia në përdorim e pronave me qëllim nxjerrjen e të ardhurave, një drejtë kjo e padiskutueshme, por këto praktika trajtohen edhe sipas ligjit të posaçëm nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, pasi trajtohen më një regjim të ndryshëm juridik, për të cilat ju jeni të detyruar të respektoni arsyetimin se kërkesat për veprimtari ndërtimore të cilat duhet të jenë për qëllime publike dhe mund të ushtrohen vetëm pasi të merret autorizimi i posaçëm nga organi kompetent për menaxhimin e burimeve ujore, ZABU Drin-Bunë, duke respektuar njëhësisht nenin 67 të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda LANGONI




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 36 datë 26.05 2022



“Për dhënien në përdorim me afat 10- vjecar sipërfaqen pyjore prej 1.8622 ha “për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme si dhe për qëllime pushime agetimi,shëndetsore,shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash,mjedise sportive,shlodhësë etj”.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020,datë 30.4.2020 “Për Pyjet”,neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” **me shumicë të cilësuar votash.**

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **1.8622 ha** në ngastrën nr. 12a,ekonomia pyjore **gomsiqe**,nga e cila **1.7ha** “për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme dhe **0.1622 ha** për qëllime pushimi,argëtimi,shëndetsore,shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash,mjedise sportive,shlodhësë etj” .
2. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti,sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve,Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 01 .06,2022